



Pranimi / Pritje Admission / Prilazje Reception / Prihvatanje	24. 01	2022	2	viti god. Year
Organ / Institucija Organi / Institutione Organs / Institutionen	SKPMSTHCL	320/2022	113	Sisto Kolicina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1128/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Zyle Millaku-Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbaitësit kanë shqyrtuar ankesën e datës 14.12.2021 me numër A.nr.1128/2021 të parashtruar nga ankuesja përmes formës elektronike me adresë:

kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.20021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike *"kërkesë nga marrëdhënia e punës"*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të shqyrtuar ankesën e datës 14.12.2021 për ankuesen me numër A.nr.1128/2021.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 14.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes formës elektronike në adresën e-mailit e punësuar në Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila është regjistruar në të njëjtën datë me numër të ankesës A.nr.1128/2021 dhe protokolluar me numër Prot:6108/2021, kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.20021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me pretendimet ankimore për ulje të pagës në masën prej 10%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më datë 13.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1128/2021 me Nr. Prot:6108/2021 të datës 14.12.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në formë elektronike E-mail: kontratën e punës së ankueses të datës 16.10.2014; Aneks kontratë e datës 06.03.2018; E-mail i datës 11.11.2021; Struktura e pagave për zbatim nga 1 Prill 2022; Vendimin me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.20021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Rregullores Nr.2/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë e datës 29.10.2021; Email i datës 11.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 14.01.2022 nr. protokoll 142/2022; E-mailin e datës 12.11.2021 për ndryshim në pagë nga (PAK SALARY STATEMENT) për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjes së ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës të datës 16.10.2014 të ankueses ka konstatuar se ankuesja mban pozitën e punës "pastruese" në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila është lidhur në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. **Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës** është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike", andaj duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankueses, Kolegji ka konstatuar se pozita "Pastruese" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil është e përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, të ankueses e vërtetuar në bazë të provave të lëndës të ankueses dhe organit të punësimit gjegjësisht Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1128/2021 e datës 14.12.2021 për rastin e ankueses

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjisllacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1128/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Luftë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

